




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Në pesë (5) pagesa të ekzekutuara nga thesari në shumë të përbashkët 283,231€, shpenzimet ishin keq klasifikuar, duke i paguar nga kategoria ekonomike e investimeve kapitale dhe e mallrave dhe shërbime, përderisa pagesat ishin për përfitimet e kontratës kolektive për arsimtarët, që duhej të ishin nga kategoria paga dhe mëditje. Po ashtu, në dy raste janë bërë pagesa në vlerë 17,800€ nga kategoria mallra dhe shërbime të cilat për nga natyra janë subvencione dhe transfere.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A1 Pasuria kapitale dhe jo kapitale kishte raste të përdorimit të jetëgjatësisë të pa saktë e cila ndikon në vlerën neto të saj, për pesë raste kishte mbivlerësim të akumuluar për 38,339€ dhe në dy raste nënvlerësim kumulativ për 15,858€.
- B2 Të detyrimet e papaguara gjashtë (6) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 47 ditë deri në 264 ditë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

## Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fushat për përmirësim janë si: keqklasifikimi i shpenzimeve, mangësi në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, vonesa në pagesën e obligimeve dhe mangësi në menaxhimin e llogarive të arketueshme. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të përsëritura, dy (2) rekomandime të reja dhe një (1) është pjesërisht e zbatuar.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas nenit 18, pika 3 e rregullores 01/2013 - MF për Shpenzimin e Parasë Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizata buxhetore duhet të aplikojnë.

Keqklasifikimet në vijim kanë të bëjnë për pagesat e pagave dhe shpërblimeve tjera për arsimtarët të parapara nga kontrata kolektive sektoriale e arsimit të paguara nga Thesari përmes vendimeve gjyqësore nga kategoritë jo adekuate si:

- Nga kodi ekonomik i investimeve kapitale janë paguar 200,000€ edhe pse janë shpenzime të kategorisë së pagave dhe mëditjeve; dhe
- Nga kodi ekonomik mallra dhe shërbime janë paguar 83,231€, edhe pse janë shpenzime të kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Po ashtu, keqklasifikim të shpenzimeve janë evidentuar edhe te shpenzimet nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve, ku janë bërë dy pagesa në vlerë të përbashket prej 17,800€, të cilat për nga natyra e shpenzimit kanë të bëjnë kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve.

Rastet kanë të bëjnë për pagesat si:

- "Furnizim me material ndërtimor për raste emergjente" në vlerë 5.800€; dhe
- "Shërbimet e rehabilitimit të bazuara në bashkësi psiko-sociale dhe fizio terapi për fëmijet me aftësi të kufizuar" në vlerë 12,000€.

Keqklasifikimi i shpenzimeve nga një kategori në tjetrën ka ndodhur si rezultat i ekzekutimit të pagesave nga ana e Thesarit për vendimet e gjykatave, për pagesat e pagave dhe shpërblimeve tjera të arsimtareve të cilat janë të përcaktuara me kontratën kolektive.

Derisa, në rastin tjetër ka pasur mungesë të mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve.

**Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria ekonomike jo-adekuate, ndikojnë në keq klasifikimin e shpenzimeve që prezantohen në PFV-të e komunës duke e mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse dhe si të tilla japin informata jo të sakta për shfrytëzuesit e tyre.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate duke përfshirë edhe për detyrimet kontigjente që janë në përfundim të procedurave kontestimore, që t'ju shmangen nevojës për ekzekutim të atyre pagesave nga kategoritë tjera ekonomike. Pastaj të njëjtat të regjistrohen në kategoritë ekonomike përkatëse në përputhje me planin kontabël të Thesarit dhe të prezantohen saktë në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)**

Me gjerësisht shih Shtojcën I





## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mangësi në regjistrim dhe vlerësim/zhvlerësim të pasurive jo financiare

#### Gjetja

Neni 1 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton procedurat standarde për dokumentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare, mbajtjen e saktë të të dhënave mbi pasurinë jo financiare përmes mirëmbajtjes sistematike të Regjistrit të Pasurive jo Financiare Kapitale, si pjesë integrale e SIMFK-së, dhe Regjistrit të Pasurive jo Financiare jo Kapitale me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerës së tyre, si dhe proceset adekuate, efikase, efektive dhe transparente të tjetërsimit të pasurive jo financiare.

Nga testimi i pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e pasurisë në SIMFK janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Pasuria me emërtimin “Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike” në vlerë 9,954€, nuk i plotëson kushtet për tu regjistruar si pasuri, andaj nuk do duhej të ishte në regjistrin e pasurive, kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë së komunës për tërë vlerën e saj;
- Pasuria me emërtimin “Autoveturë Xhip Toyota 4 Runner” në vlerë 4,137€, e regjistruar në vitin 2007, do duhet të ishte zhvlerësuar tërësisht, andaj kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë së komunës për këtë vlerë;
- Pasuria me emërtimin “Ndërtimi i parkut të qytetit në lokacionin e ish ndërmarrjes publike Radusha” në vlerë 75,409€, ishte si investim në vijim duke mos u zhvlerësuar, edhe pse ishte në funksion dhe duhej të zhvlerësohej për dy vite, andaj kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë së komunës për 3,770€;
- Pasuria me emërtimin “Asfaltimi i rrugës Drenusha -Lubovë” në vlerë 55,000€, ishte si investim në vijim duke mos u zhvlerësuar, edhe pse ishte në funksion dhe duhej të zhvlerësohej për tri vite, andaj kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë së komunës për 8,250€;
- Pasuria me emërtimin “Sistemi elektronik për administrimin e subvencioneve komunale” në vlerë 2,360€, nuk është regjistruar me jetëgjatësinë e duhur 10 vjeçare, por 3 vjeçare, duke e zhvlerësuar për 2/3 e saj, e që duhej të ishte 2/10 e saj, respektivisht duke e ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë së komunës për 1,101€;
- Pasuria me emërtimin “Ndërtimi i objektit dhe rregullimi i hapësirës për deponim të druve të konfiskuara” në vlerë 8,433€, nuk është regjistruar me jetëgjatësinë e duhur 40 vjeçare, por 10 vjeçare, duke e zhvlerësuar për 7/10 e që duhej të ishte 7/40 e saj, respektivisht duke e ndikuar në nënvlerësimin e pasurisë së komunës për 14,757€; dhe
- Pasuria me emërtimin “Zëvendësimi i gypit të azbestit - ujësjellësit në Banjë” në vlerë 101,989€, ishte si investim në vijim duke mos u zhvlerësuar, edhe pse ishte në funksion dhe duhej të zhvlerësohej për tri vitet e kaluar, andaj kjo ka ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë së komunës për 12,228€.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së

udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e menaxhimit të pasurive dhe korrigjimeve të nevojshme në regjistrin e pasurive sipas nevojës së gjendjeve reale të vlerave të tyre.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i duhur i pasurive sipas jetës së përdorimit, dhe mos korrigjimi i regjistrit të pasurive sipas ndryshimeve të pronësisë dhe vlerës së pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korrigjimin e regjistrit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korrigjuar vlerat e pasurive me statutin "Investime në vijim" dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuara me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar

**Gjetja** Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë trajtimit të detyrimeve të papaguara kemi vërejtur se gjashtë (6) fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 47 ditë deri në 264 ditë:

- Fatura e pranuar me 24.12.2021 në vlerë 8,880€, ishte paguar me 14.10.2022; dhe
- Fatura e pranuar me 22.11.2022 në vlerë 1,599€, ishte paguar me 09.03.2023.

Për më tepër, faturat të cilat ishin ende të papaguara edhe deri në përfundim të punës audituese në terren (datë 11 maj 2023) ishin:

- Fatura e pranuar me 09.12.2022 në vlerë 2,327€;
- Fatura e pranuar me 12.07.2022 në vlerë 131€;
- Fatura e pranuar me 20.12.2022 në vlerë 7,180€; dhe
- Fatura e pranuar me 20.12.2022 në vlerë 8,440€.

Shkaku i mospagesës së faturave të detyrimeve me kohë ishte mungesa e kontrolleve të brendshme funksionale dhe mungesa e mjeteve të buxhetuara për kodin ekonomik përkatës.

**Ndikimi** Detyrimet e bartura nga vitet paraprake rrisin rrezikun e realizimit të projekteve dhe arritjen e objektivave vjetore të komunës. Po ashtu, në rast të padive nga furnitorët mund të krijohen edhe kosto shtesë.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të arkëtueshmet

Komuna në PFV kishte prezantuar llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,888,787€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 1,615,860€, nga taksa komunale për leje ndërtimi 36,956€, ngarkesat për afarizëm në biznes 174,831€, nga qiraja (e tokës dhe lokaleve) e papaguar 50,520€ dhe nga ngarkesa për sherbime të pijeve alkoholike 10,620€.

#### Çështja B3 - Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenin 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10€) dhe neni 27 nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të Arkëtueshme (LIA). Siç shihet edhe më lartë, vlera e LIA për tatimin në pronë, taksat në biznes dhe qiraja e papaguar, mbesin ende me vlera të larta dhe me trend rritës nga viti në vit, respektivisht ka një rritje të LIA-ve rreth 16% krahasuar me vitin paraprak.

Komuna nuk kishte ndërmarr veprime konkrete për mbledhjen e këtyre borxheve, megjithëse, kjo situatë është ngritur si çështje dhe vitin e kaluar.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale e qytetarëve të komunës, ka sjell, deri të mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, ndërsa për taksat në biznese aty ka shumë biznese joaktive.

**Ndikimi** Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve për vite me radhe, ndikon që ato të bëhen të pambledhshme dhe gjithashtu rezulton me të hyra vetjake me pak për komunën.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LIA nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LIA nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.2 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte vetëm një Auditor (Drejtorin e njesisë). Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin planifikuar të kryhen katër (4) auditime. Prej tyre, vetëm dy (2) auditime ishin përfunduar për shkak të stafit të pamjaftueshëm të NjAB-së. Auditimet ishin fokusuar në fushën e shëndetësisë, pasurive dhe menaxhimit të tyre.

#### Çështja C1 - Komiteti i auditimit jo funksional

**Gjetja** Udhzimit Administrativ MF-NR. 01/ 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, Neni 6 Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitën udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.

Komiteti i Auditimit (KA) të Brendshëm nga marsi ishte pa kuorum (dy prej tyre ishin tërhequr nga komiteti i auditimit) deri në dhjetor të vitit 2022, kur u kompletua me përbërje të re.

Po ashtu komiteti i auditimit nuk i ka mbajtur katër takime që janë obligative, por vetëm dy.

Mos funksionimi efektiv i KA-së ka ndodhur si pasojë e largimit të kryetarit dhe anëtarit të KA-së pasi i ka skaduar mandati, dhe komuna nuk ka emëruar anëtarët e rinj me kohë.

**Ndikimi** Komiteti i Auditimit jo efektiv ka ndikim në dhënjen e sigurisë për efektivitetin e kontroleve të brendshëm të komunës, funksionimin e auditimit dhe pavarësinë e auditimit të brendshëm.

**Rekomandimi C1** Kryetari, duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit, në mënyrë që të rishikojë planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit për funksionimin e kontroleve të brendshme.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A2 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

**Gjetja** Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik. Neni 5.1.1 përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Istogut, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njesisë së auditimit dhe nuk ka anëtarë tjerë si auditor të brendshëm.

Komuna nuk ka ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përbërjes dhe funksionit të Njesisë së Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.

**Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB-së, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohë sa më të hershme.

**Rekomandimi A2** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë, dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>11,611,999</b>	<b>12,760,811</b>	<b>11,589,771</b>	<b>11,920,156</b>	<b>13,665,096</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	10,451,384	10,532,882	9,897,405	9,385,694	9,897,884
Financimi përmes huamarrjes	0	98,602	98,602	25,031	92,580
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	144,806	0	1,528,317	2,402,275
Të bartura nga viti i kaluar	0	777,218	616,338	0	426,373
Të hyrat vetanake	1,160,615	1,160,615	945,931	941,700	638,792
Donacionet vendore	0	46,164	31,495	39,414	31,545
Donacionet e jashtme	0	523	0	0	175,649

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,148,812€. Kjo rritje është rezultat i ndryshimit të bëra nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti paraprak, nga financimi përmes huamarrjes, nga huamarrja përmes klauzolës së investimeve, nga donacionet vendore, dhe nga efekti i vendimit të qeverisë për shtesat në pagë për punonjësit shëndetësor të sektorit publik.

Në vitin 2022 Istogu ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 11,589,771€, me një ulje rreth 3% në krahasim me vitin 2021. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.




Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>11,611,999</b>	<b>12,760,811</b>	<b>11,589,771</b>	<b>11,920,156</b>	<b>13,665,096</b>
Pagat dhe mëditjet	6,511,000	6,691,101	6,638,555	6,160,659	6,211,773
Mallrat dhe shërbimet	1,593,959	1,923,439	1,829,768	1,227,191	1,482,803
Komunalitë	202,000	202,000	188,599	157,882	174,280
Subvencionet dhe transferet	310,000	376,454	347,736	321,811	315,008
Investimet Kapitale	1,408,395	3,567,817	2,585,113	4,052,614	5,481,234
Rezervat	1,586,645	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Kategoria e pagave dhe medijëve në buxhetin final kishte një rritje për 180,101€ krahasuar me buxhetin fillestar dhe një realizim 99% të buxhetit.
- Kategoria mallra dhe shërbime në buxhetin final kishte një rritje për 329,480€ dhe kishte një realizim 95% të buxhetit.
- Kategoria e komunalive në fund të vitit nuk kishte ndonjë ndryshim të buxhetit dhe kishte realizuar 93% të buxhetit.
- Kategoria subvencioneve dhe transfereve, në fund të vitit kishte rritje të buxhetit për 66,454€ dhe kishte realizuar 92% të buxhetit.
- Kategoria investime kapitale në fund të vitit, kishte rritje të buxhetit për 2,159,422€, dhe në fund të vitit ishte realizuar në vlerë 2,585,113€ apo 72% të buxhetit.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Istogu në vitin 2022 ishin në vlerë 1,079,823€ apo rreth 93% nga planifikimi. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksa për lejet e ndërtimit, taksat për certifikata të ndryshme, të hyrat nga regjistrimi automjeteve, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës, taksë për regjistrim të trashëgimisë, të hyrat nga participimet (shëndetësi, arsim), të hyrat tjera administrative, etj.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,160,615</b>	<b>1,160,615</b>	<b>1,079,823</b>	<b>1,072,090</b>	<b>787,307</b>
Të hyrat tatimore	570,395	570,395	422,826	474,062	299,468
Të hyrat jo tatimore	590,220	590,220	656,667	598,028	487,840
Të hyrat tjera	0	0	330		


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të Istogut ka rezultuar në 14 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, katër (4) rekomandime nuk ka filluar zbatimin, dhe një (1) pjesërisht i zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë përgatitjes së PFV-ve, në mënyrë që tabelat dhe shpalosjet për vitin 2022 të mos përmbajnë gabime dhe të ndërmerr masa adekuate ndaj personave përgjegjës për mos prezantim të saktë të të dhënave në PFV për dy vite radhazi. Po ashtu, duhet të sigurohet se deklarata e dhënë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk nënshkruhet, nëse nuk janë zbatuar të gjitha kontrollet e nevojshme sipas draft PFV-ve.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar

2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj që Llogarit e arketueshme të prezantohen në pasqyrat financiare, sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore. Po ashtu, duhet të siguroj se personat përgjegjës për mbajtjen e regjistrave të Llogarive të arketushme dhe Zyrtari Kryesor Financiar bashkëpunojnë dhe japin vlera të sakta të Llogarive të arketushme me rastin prezantimit të tyre në PFV.	Ketë vit nuk kemi identifikuar çështje të njëjtë.	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta, duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë për pozita jo të rregullta.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
5.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të siguroj që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax. Gabimet dhe defektet që ndodhin në sistemin Protaks duhet të trajtohen dhe zgjidhen në bashkëpunim me Departamentin e Tatimit në Pronë në kuadër të ministrisë së financave punës dhe transfereve.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të siguroj se përfaqësuesi juridik i komunës, ndërmerr veprimet e nevojshme brenda afateve kohore në rastet kur është i nevojshëm përfaqësimi juridikë i komunës për tu mbrojtur interesi i Komunës.	Edhe ketë vit është identifikuar çështje e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj përmbushjen e kërkesave ligjore në përgatitjen e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të, dhe raportimin e planit në ZKM në afatin e përcaktuar.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar

9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj që thirrjet publike për subvencionim të përmbajnë të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregulloren mbi Kriteret Standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve, pastaj të kërkoj nga OJQ-të të dorëzojnë raporte kthyesë financiare dhe narrative si dhe për çdo përfitues të subvencionit të caktojë zyrtar monitorues.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë regjistrohen në regjistrin e pasurisë në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të përdoret për evidentimin e pasurive nën 1000€.	Ketë vit nuk është identifikuar çështje e njëjtë.	I zbatuar
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve duke shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Edhe ketë vit është identifikuar çështje e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatim
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurohet që të gjitha faturat dhe detyrimet financiare paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhen vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Edhe ketë vit kemi identifikuar vonesa të detyrimeve.	Nuk ka filluar zbatim
14.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj veprimet e nevojshme që KA të ketë përbërje të plotë dhe të siguroj funksionimin e KA-së në mënyrë që komiteti të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit. Gjithashtu, KA duhet të monitoroj veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit.	Edhe ketë vit është identifikuar çështje, megjithëatë Komiteti i AB është themeluar me 16.12.2022.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Enver Boqolli, Udhëheqës i ekipit



Aurora Morina, Anëtare e ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keqklasifikimi i shpenzimeve	<p>Siç kemi diskutuar edhe në takimin e datës 29.05.2023, se nuk pajtohemi me kualifikimin e draft-raportit të Auditorit.</p> <p>Arsyeja është se për çështjen B1 të kualifikohet Raporti i Auditimit të Komunës së Istogut, është i pa drejtë nga ana e procedurës, ashtu siç jeni të njoftuar edhe ju që për shkak të vendimeve Gjyqësore e cila është kompetencë ekskluzive e Thesarit e jo e Komunave, ku janë ekzekutuar këto pagesa nga Thesari, të vendimeve Gjyqësore (shujtave e transportin për Mësimdhënës) nga Investimet kapitale, nga fondet burimore 22 dhe 10, si dhe nga kategoria ekonomike e Mallra dhe shërbime, ku vendimet janë ekzekutuar pa koordinim me ZKF-në e komunës sonë.</p>	<p>Edhe pse pagesa është bërë nga Thesari, PFV nuk prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, për shkak të keq klasifikimit.</p>



Komuna e Istogut  
Opština Istokllog  
Municipality



## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022  
dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese:

- Konfirmoj se kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Siç kemi diskutuar edhe në takimin e datës 29.05.2023, se nuk pajtohem me kualifikimin e draft-raportit të Auditorit;
- Arsyeja është se për çështjen B1 të kualifikohet Raporti i Auditimit të Komunës së Istogut, është i pa drejtë nga ana e procedurës, ashtu siç jeni të njoftuar edhe ju që për shkak të vendimeve Gjyqësore e cila është kompetencë ekskluzive e Thesarit e jo e Komunave, ku janë ekzekutuar këto pagesa nga Thesari, të vendimeve Gjyqësore (shujtave e transportin për Mësimdhënës) nga Investimet kapitale, nga fondet burimore 22 dhe 10, si dhe nga kategoria ekonomike Mallra dhe shërbime, ku vendimet janë ekzekutuar pa koordinim me ZKF-në e komunës sonë.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ilir FERATI  
(Kryetar i Komunës),

Data: 12.06.2023, Istog,





## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.